



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:241704
Datë: 04.09.2024
Numri i dokumentit: 06121289

C.nr.1023/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren individuale Erolinda Uka , në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses, T.A.,nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati F.J., me seli në Mitrovicë, kundër të paditurit, U I. B., Mitrovicë, me seli në Mitrovicë me objekt kontesti, anulimin e vendimit 478/2 të Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, pagesën e të ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e publik, me datën 04.09.2024, hartoi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses T.A.,nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.478 i datës 25.10.2022, i Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore pranë Universitetit Isa Boletini në Mitrovicë, me të cilin është anuluar konkursi nr.2046 i datës 14.09.2022 për pozitën një asistent për ligjërata dhe ushtrime, për vitin akademik 2022/2023, për lëndët: Trajtimi i Ujërave të Zeza, Monitorimi i Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujërave të Ndotura, Trajtimi i Ujërave të Zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produktet Ushqimore, pranë të paditurit Universiteti “I.B” në Mitrovicë, dhe të obligohet i padituri që paditëses t’ia kompensojë në emër të pagave neto shumën 1.088.39 euro, në emër të tatimit të kursimeve pensionale shumën prej 62.35 euro, në emër të tatimit në burim shumën prej 96.26 euro, në emër të kamatës prej datës së parashtrimit të padisë datës 11.11.2022 shumën prej 109.68 euro shumën totale prej 1.356.68 euro, si dhe shpenzimet e procedurës civile në shumë prej 979.00 **si e pabazuar.**

II.OBLIGOHET paditësja T.A., që t’ia kompensojë shpenzimet procedurale të paditurit Universitetit “I.Bi” në Mitrovicë, në shumën prej 779 euro në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të tij, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj avokatit F.J., me seli në Mitrovicë, me datën 11.11.2022, pranë kësaj gjykata ka paraqitur padi të cilën e ka precizuar në seancës e datës 24.04.2024, kundër të paditurit Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi numër 478 i datës 26.10.2022, me të cilin është anuluar konkursi 2046 për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit “I.B.” në Mitrovicë për vitin akademik 2022/2023, pranë të paditurit Universiteti “I.B.” në Mitrovicë, dhe të obligohet i padituri që paditëses t’ia kompensojë në emër të pagave neto pagave neto shumën 1.088.39 euro, në emër të tatimit të kursimeve pensionale shumën prej 62.35 euro, në emër të tatimit në burim shumën prej 96.26 euro, në emër të kamatës prej datës së parashtrimit të padisë datës 11.11.2022 shumën prej 109.68 euro shumën totale prej 1.356.68 euro.

Shpenzimet e procedurës si në vijim: në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 €, për pesë seanca të mbajtura shumën prej 135 € për seancë, për ekspertizë të përpiluara në shumë prej 200 €.

I autorizuari i të paditurës, në fjalën përfundimtare deklaroi se qëndrojmë pranë përgjigjes në padi dhe të thënave në seancat paraprake e kontestojmë në tërësi si të pabazuar dhe të pathemeltë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Ne konsiderojmë se tani kemi të bëjmë me një lëndë pa objekt të shqyrtimit sepse ndërmjet paditëses dhe të paditurës në këtë rast asnjëherë nuk ka pasur kontratë të nënshkruar përkatësisht nuk ka pasur të drejta dhe detyrime të vitit akademik të ri, pra ka kaluar viti akademik për të cilin bëhet fjalë këtu sepse angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm profesional bëhet për semestër përkatësisht vit akademik dhe nuk mund të kthehemi në kohë. Tani jemi në vitin akademik 2023-2024 dhe këtu bëhet fjalë për atë 2022-2023 e që viti akademik 2022-2023 ka përfunduar më 30.09.2023. andaj ne konsiderojmë se nuk ka interes juridik të shqyrtohet meqenëse periudha për të cilën ka qenë konkursi tashmë ka kaluar sepse angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional bëhet për një semestër përkatësisht dy semestra të njëjtë vit akademik. Edhe sikur të mos kishte kaluar viti akademik për të cilin zhvillohet kjo çështje gjyqësore kjo padi është e pabazë dhe e pathemeltë sepse komisioni vlerësues ka shkelur Rregulloren për Procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në IIBM –nr. protokolli 1670 dt.28.09.2021 nenit 6 pika 12 dhe neni 7 të cilat shkelje i ka evidentuar dhe argumentuar komisioni i ankesave. Rolin më të madh që i ka shtyrë në marrjen e vendimit për anulimin e konkursit përkatës është që asnjëra nga kandidatet nuk i ka dëgjuar të gjitha lëndët për të për të cilat ishte konkursi, përkatësisht 40% e lëndëve nuk janë dëgjuar. Andaj kërkojmë nga gjykatë që ta refuzojë si të pabazuar dhe të pathemelte kërkesëpadinë e paditëses dhe të njëjtën ta obligojë në kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe atë për përgjigje në padi shumën prej 104 euro, për përfaqësim në pesë seanca gjyqësore nga 135 euro.

1. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: konkursin nr.2046 i datës 14.09.2022, Raporti i Komisionit Vlerësues numër 439 datës 04.10.2022, Raporti i Komisionit për Ankesa dhe parashtesa nr. 453 i datës 21.10.2022, ankesa e parashtruar nga paditësja me datën 28.10.2022, Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore me numër 478 i datës 26.10.2022, Njoftimi për Kandidatët e Suksesshëm nr. 2662 i datës 01.11.2022, Njoftimi për nënshkrimin e kontratës nga S.G., Vendimi mbi formimin e komisionit vlerësues nr.428 i datës 30.09.2022, Raporti i Komisionit Vlerësues me nr.439 i datës 04.10.2022, Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore i datës 07.10.2022, Pasqyra e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore e propozimeve të zgjedhjen e personelit akademik-bashkëpunëtoreve sipas konkursit të shpallur me datën 14.09.2022, i datës 07.10.2022, Vendimi mbi Themelimin e komisionit të ankesave me nr të protokollit 457 i datës 07.10.2022, Ankesa e parashtruar nga Y.B. me datën 17.10.2022, Vendimi i Kshillit të Teknologjisë Ushqimore i datës 25.10.2022, Procesverbali i Mbledhjes XLI të Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore e datës 25.10.2022, Certifikatat, mirënjohja, referenca, Punimi i publikuar, letër referenca, pjesëmarrja në sesionet teknike të datës 04,05, dhe 06.11.2020 për Y.B.ne konferencën uji dhe ndryshimet klimatike, pjesëmarrja e së njëjtës në programin vlera e ujit, të dhëna në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, Pasqyra e trustit lidhur me Y.B., Certifikata e Ylberin Baliu për pjesëmarrjen në trajnim të mbajtur në Holand me datën 01.04.2021, Certifikata e lëshuar nga AUK për Y.B, certifikata e lëshuar nga YEP lidhur me përfundimin e dy viteve si eksperte për programin e ujit, lexohet vërtetimi i lëshuar nga kompania YES i datës 26.09.2022 për Y.B., shiqohet CV-ja për Y.B Të dhënat lidhur me ankesën e parashtruar nga Y.B.me datën 17.10.2022, Pyetjet për pozitën asistent-bashkëpunëtor për kandidatët T. A. dhe Yl. B., Pasqyra financiare e llogarisë bankare për T.A, Pasqyra e llogarisë e lëshuar nga trusti për T.A, Rregullorja për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm në Universitetin “Isa Boletit” Mitrovicë i miratuar me datën 27.09.2021, Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat e funksioneve, honorarët dhe komisionet e përhershme miratuar me datën 18.09.2020, Kontrata e punës me honorarë me nr. të protokollit 2819/1 e datës 08.11.2022, Ekspertiza financiare e datës 08.12.2023 e përpiluar nga eksperti financiarë Mujë Ferati, Plotësimi i ekspertizës financiare i datës 25.03.2024 nga eksperti financiarë Mujë Ferati.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e pa bazuar**.

2. Faktet

Me leximin e konkursit nr.2046 të datë 14.09.2022, gjykata vërtetoi faktin se e paditura me datën 13.09.2022, ka shpallur konkurs për Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore për pozitën “një asistent për lëndët: Trajtimi i Ujërave të Zeza, Monitorimi i Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujërave të Ndotura, Trajtimi i Ujërave të Zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produktet Ushqimore.

Nga leximi i Vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues nr. protokollit 428 të datës 20.09.2022, vërtetohet fakti se Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore me datën

20.09.2022, ka nxjerrë vendim duke formuar komisionin vlerësues për kandidatët të cilët janë paraqitur në konkursin e shpallur për përzgjedhjen e një asistenti në lëndët “ Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, teknologji e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura, trajtimi i ujërave të zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produkte të ushqimore n përbërje prej 1.Prof..Asoc.Dr.Sadija Kadriu, 2.Prof.Asoc.Dr.Mehush Aliu dhe 3.Prof.Asoc.Dr.Valdet Gjinovci.

Nga leximi i Raporti i Komisionit Vlerësues sipas konkursit për angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm për vitin akademik 2022/2023, me numër 439 të datës 04.10.2022, gjykata vërtetoi faktin se kandidatët e paraqitur për lëndët Trajtimi i Ujërave të Zeza, Monitorimi i Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujrave të Ndotura, Trajtimi i Ujërave të Zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produktet Ushqimore, janë Y.B., B.S., T.A., A. D., A. M. dhe A.D..

Për kandidaten Y. B. e lindur më në M., me gradë shkencore masteri i Shkencës në Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, Universiteti i Mitrovics “ Isa Boletini” Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, Master i shkencës në Inxhineieri dhe Teknologji Ushqimoor, 2021, 9.12, studimet themelore në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina” Fakulteti i Gjeoshkencës dhe Teknologjisë 2016, 8.47.

Për kandidaten Y.B., tek tabela I (përmbledhja e aktivitetit shkencor për kandidatit) rezulton se nuk janë shënuar aktivitetet shkencore për këtë kandidate , tek tabela II (mentorimi) nuk është shënuar asnjë e dhënë për kandidaten Ylebrinë Baliu, e po ashtu as në fushën e përvojës komisioni nuk ka shënuar asnjë të dhënë, në tabelën e tretë për publikimin e monografive, librave, kapitujve të librave dispensave, tabelën e IV për publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet në nivel ndërkombëtar dhe vendor, tabelën V për ligjërata-prezantime, ligjërues i ftuar në universitet dhe punëtori shkencore nga lëmi i kandidates si dhe tek tabela e VI. Për rekdator/recesent në revistat akademike apo shkencore nuk është konstatuar asnjë e dhënë nga Komisioni Vleresues.

Kandidatja B.S. e lindur më në M., master i Shkencës në Inxhinierinë e mbrojtjes së mjedisit, studimet e doktoratës i ka ka në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina” Fakulteti i shkencave Matematike Natyrore në Prishtinë, Biologji e organizmave dhe Ekologji 2019, studimet master i ka në Unviversitetin e Mitrovicës “ Isa Boletini” Fakulteti i Teknologjisë ushqimore, Programi Inxhinieri e Mbrojtjes së mjedisit, master i Shkencës në inxhinierinë e mbrojtjes së mjedisit 2016, 9.53, studimet themelore në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore në Prishtinë, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Ambientit, Bachelor i Biologjisë-drejtimi Ekologji mbrojtje e mjedisit , 2014, 8.32.

Kandidtaja T.A, e lindur më në M....., Master i Shkencë në Inxhinierinë e Mbrojtjes së Mjedisit, studimet master i ka përfunduar në Universitetin e Mitrovicës “ Isa Boletini” Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Programi Tekonologji-Specializimi Inxhinieri e mbrojtjes së mjedisit, master i shkencave në inxhinierinë e mbrojtjes së mjedisit, 2018. 9.35,

studimet themelore i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina” Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë-Inxhinieri e mbrojtjes së mjedisit, Departamenti i Teknologjisë, Bachelor i Teknologjisë 2015, 8.75.

Kandidatja A. D., e lindur më në T....., me gradë shkencore doktor në Kimi Industriale, studimet e doktoratës i ka përfunduar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Tiranë, Kimi industriale, Doktor në Kimi Industriale 2011, studimet master i ka përfunduar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore- Departamenti i Kimisë industriale, Master në Kimi Drejtimi Inxhinieri Ushqimore, 2006, ndërsa studeimt themelore i ka përfunduar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Dega Kimi Industriale, 2001.

Kandidati A.M, i lindur më në F....., me gradë shkencore master i Shkencave të Kimisë, kandidat i doktoratës në Universitetin e Prishtinës, “ Hasan Prishtina” Departamenti i Kimisë, studimet master i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, “ Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore në Prishtinë-departamenti i Kimisë, programi Kimi analitike dhe mjedisore, master i shkencave të kimisë, 2020, 9, studimet themelore i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina’ Fakulteti i shkencave Matematike Natyrore në Prishtinë-Departamenti i Kimisë-Programi Kimi, 2017, 8.59.

Kandidatja A.D., e lindur më në Mitrovicë, me gradë shkencore Master i Shkencës në Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, studimet master i ka përfunduar në Universitetin e Mitrovicës, “ Isa Boeltini” në Mitrovicë, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, Master i Shkencës në Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore 2021, 9.41, studimet themelore i ka përfunduar në Universitetin e Mitrovicës, “ Isa Boeltini” në Mitrovicë, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, programi Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, 2017, 9.47.

Komisioni vlerësues pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve ka konstatuar se kandidatja A.D., nuk e ka dorëzuar vendimin nr nostrifikim të diplomës Bachelor, Master dhe diplomës së doktoratës, ashtu si parashihet me nenin 5 pikë 9 e rregullore 1670, datë 28.09.2021, kandidatja Y.B., A.D., B.S., T. A. dhe A.M. i plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur asistent bashkëpunëtorë mirëpo duke marrë parasysh dokumentacionin e ofruar prej kandidatëve dhe në bazë të rezultateve të intervistimit, komisioni vlerësues i jep përparësi kandidates T.A. që i propozon Këshillit të fakultetit të Teknologjisë Ushqimore që kandidatja Teuta Abazi të zgjidhet asistente bashkëpunëtoe për lëndët: Trajtimi i Ujërave të Zeza I, Monitorim i Ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujërave të ndotura, Trajtimi i Ujërave të Zeza II dhe Materiet Ndotëse në produktet ushqimore me arsytim se kandidatja T.A., gjatë studimeve ka arritur notën mesatare mbi 8 në të dy nivelet e studimit është nën moshën .. vjeç, si dhe ka marrë pjesë në kurse dhe trajnime të ndryshme në lidhje me fushën e inxhinierisë mjedisore dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Nga pyetjet e testit me shkrim të mbajtur me datën 07.10.2022, u vërtetua fakti se me datën 07.10.2022, T.A. dhe Y.B. i janë nënshtruar testit-intervistimit për pozitën e asistentit bashkëpunëtor me nga gjashtë pyetje si në vijim: uji i fortë i ka anët pozitive cilat janë ato, cilat

janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të ozonit në dezinfektimin e ujit, jepni mendimin tuaj që duhet ndërmarre në procesin e trajtimit të ujërave të zeza, gjatë trajtimit të ujërave shkarkuese nga industria a mund të përfitohet energjia dhe si, gjatë projektimit të reaktorit aeorob çka duhet të mirret parasysh dhe çka paraqet për juve fjala monitorim, në korrelacion me hulumtimin e sistemeve ujore.

Nga leximi i Vendimit nr.453 datë 07.10.2022 të marrë nga Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore rezulton se në pikën I të dispozitivit të vendimit a aprovuar raportet e komisioneve recensuese të emëruara nga Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore sipas konkursit 2046 datë 14.09.2022 për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi Këshilli në mbështetje të rregullores 1670 të datës 28.09.2021 i ka propozuar Senatit të UIBM-së miratimin e propozimit për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, Universiteti “ I.B.” në Mitrovicë ndërsa në pikën III të dispozitivit pika d) është miratuar raporti i komisionit recensues për asistentë.

Nga leximi i Vendimit mbi themelimin e Komisionit të Ankesave të Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore më datë 07.10.2022, vërtetohet fakti se për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm është formuar komisioni në përbërje prej Prof. Ass.Dr.Besire Cenna-kryesuese dhe anëtarëve Ass. Malesore Pllana dhe Ass.Arbër Hysnei.

Nga leximi i Ankesës së kandidates Y.B. të parashtruar me datën 17.10.2022, drejtuar Komisionit për ankesa dhe Parashtrësia lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, vërtetohet fakti se kandidatja Y. B., me datën 17.10.2022 ka kërkuar anulimin e konkursit për pozitën asistent për lëndët Trajtimi i Ujërave të Zeza, Monitorimi i Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujërave të Ndotura, Trajtimi i Ujërave të Zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produktet Ushqimore si dhe të rihapet konkursi për në lidhje me pozitën e lartcekur, pasi që Komisioni Vlerësueses ka shkelur Rregulloren nr. 1670 të datës 28.09.2021 në katër pika duke mos i përshkuar të dhënat lidhur me përmbledhjen e aktivitetit të kandidatit, publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet në nivel ndërkombëtar dhe vendor, përvojën menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqjen në hulumtimin e kandidatit si dhe mobilitetin e kandidatit.

Nga leximi i Raportit i Komisionit për ankesa dhe parashtrësia me nr. të protokolit 453 i datës 21.10.2022 vërtetoi faktin se Komisioni për Ankesa dhe parashtrësia në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore pasi shqyrtoi ankesën e kandidates Y.D.të njëjtën e pranoi si të bazuar, në mendimin dhe kontestimin e këtij raporti theksohet se komisioni vlerësues nuk i ka ofruar të dhënat e plota për kandidaten Y.B si në vijim: mos përfshirja e punimit shkencor të publikuar nga ana e kandidates Y.B, e dëshmuar në dokumentacionin e kandidates, mos përfshirja e dy publikimeve nga konferencat e përbashkëta ballkanike të dëshmuar në dokumentacionin e kandidates, përvoja e punës katër vjeçare e kandidates YI.B. në fushën menaxhimit të ujërave të ndotura nuk është shkruar saktë pasi që është vlerësuar si trajnim apo kurs ndërsa ka qenë e dokumentuar në emër të kandidates, mobiliteti nuk është shënuar saktë nga cila datë deri kur ka zgjatë vetëm viti 2019 dhe është përshkuar tek trajnimin dhe kurset e ndjekura jo tek mobiliteti i kandidatit/tes.

Tutje Komisioni ka gjetur se asnjë pike e rregullores 1670 datës 28.09.2021 në lidhje me procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM nuk thotë se kandidatët duhet të testohen përkatësisht të futen në provim, pra këtu kanë vepruar në kundërshtim me rregulloren pasi kandidatët janë thirrur nga komisioni vlerësues t'i nënshtrohen provimit. Kandidatja e cila është përzgjedhur si e suksesshme nga Komisioni Vlerësues rezulton se nuk e ka dëgjuar një lëndë në të cilën ka aplikuar, kandidatja tjetër e cila pretendon se lëndët Trajtimi i Ujërave të Zeza I dhe Trajtimi i Ujërave të Zeza II korrespondojnë me lëndët e dëgjuara gjatë mobilitetit, të njëjtën lëndë sikur kandidatja e përzgjedhur nuk ka dëgjuar a kandidatja tjetër.

Nga leximi i ankesës së paditëses T.A., drejtuar Rektoratit të Universitetit “ Isa Boletini” në Mitrovicë, vërtetohet fakti se e njëjta me datën 28.10.2022, ka parashtruar ankesë ndaj raportit nr. 453 të datës 21.10.2022, të Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore.

Nga leximi i Vendimit të datës 25.10.2022 lëshuar nga Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, vërtetohet fakti se me pikën II të dispozitivit të këtij vendimi është aprovuar si e bazuar ankesa e parashtrueses Y.B. me nr prototkollit 442 datë 17.10.2022 ndërsa në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi është anuluar konkursi i shpallur për pozitën “ një asistent për lëndët trajtimi i ujërave të zeza Monitorimi i Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujërave të ndotura trajtimi i ujërave të zeza II, materiet ndotëse në produktet ushqimore për shkak të shkeljeve procedurale.

Nga leximi i Njoftimit me numër 2662 datë 01.11.202, u vërtetua fakti se Universiteti i Mitrovicës- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në pikën e nëntë (9) ka anuluar konkursin për pozitën një asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, teknologji e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura, trajtimi i ujërave të zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produkte të ndryshme, me këshillën juridike se pala e pakënaqur mund të hapë kontest punë ne Gjykatën kompetente në afat prej 15 ditësh.

Nga leximi i procesverbalit të mbledhjes së XLI të Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, me datën 25.10.2022 rezulton se në pikën e tretë të rendit të ditës ka qenë Shqyrtimi dhe Miratimi i Raporteve të Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia sipas konkursit për bashkëpunëtorë të datës 14.09.2022, lidhur me ankesën e kandidatës Y.B. anëtarët e komisionit ishin deklaruar Prof. Sadija Kadriu kishte deklaruar se është inkuadruar me vonesë në komision dhe se njeriu i gjallë gabon, ka qenë kohë e shkurtër dhe jemi ballafaquar me probleme shëndetësore në familje dhe nuk kam mundur të kontribuojë me tërë qenien time, sa i përket provimit ne jemi nisur nga ajo sipas përzgjedhjes së kandidatëve të ngushtë të behët intervistomi por edhe ky ka qenë një gabim dhe e konsideroj të arsyeshëm raportin e komisionit të ankesave.

Gjykata shqyrtoi të gjitha dokumentet e kandidates Y.B., si në vijim Certifikatat, mirënjohja, referenca, Punimi i publikuar, letër referenca, pjesëmarrja në sesionet teknike të datës 04,05, dhe 06.11.2020 për Y.B. ne konferencën uji dhe ndryshimet klimatike, pjesëmarrja e së njëjtës në programin vlere e ujit, të dhëna në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, Pasqyra e trustit lidhur me Y.B., Certifikata e Y. B.për pjesëmarrjen në trajnim të mbajtur në Holand me datën 01.04.2021, Certifikata e lëshuar nga AUK për ., certifikata e lëshuar nga YEP lidhur me përfundimin e dy viteve si eksperte për programin e ujit, lexohet vërtetimi i lëshuar nga kompania YES i datës 26.09.2022 për Y.B., CV-ja , e për të cilat vërtetoi se të njëjtat nuk janë përshkruar

nga Komisioni për Shqyrtimin e Dokumentacionit, në formë tabelare ashtu siç ishte përcaktuar në nenin 6 pikën 12 të Rregullores për Procedurat Vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Nga leximi i Njoftimit për nënshkrimin e kontratave, nga S.. rezulton se paditësja është njoftuar se si në vijim: “Kontratat për bashkëpunëtorë të jashtëm janë gati, mund të vini t’i nënshkruani tek zyra e personelit”.

Me leximin ekspertizës financiare e dt. 25.03.2024, gjykata vërtetojë faktin se lartësia e pagës të cilat do t’i merrte paditësja si bashkëpunëtorë e jashtëm tek e paditura, është në lartësi prej emër të pagave neto shumë 1.088.39 euro, në emër të tatimit të kursimeve pensioneve shumë prej 62.35 euro, në emër të tatimit në burim shumë prej 96.26 euro, në emër të kamatës prej datës së parashtrimit të padisë datës 11.11.2022 shumë prej 109.68 euro shumë totale prej 1.356.68 euro.

1. Ligji i aplikueshëm

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, parashihet që *“Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.”*

Në bazë të nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 i Ligjit të Punës, parashihet që *“Marrëdhënia e Punës - një marrëveshje ose rregullim kontraktual ndërmjet një punëdhënësi dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi specifike nga i punësuarit nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese të dakorduar, zakonisht në formë të parave;”*

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 i Ligjit të Punës, parashihet që *“Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.”*

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës, parashihet që *“I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit .”*

Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 i Rregullores nr.1670 e datës 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (tutje Rregullorja), parashihet që *“angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër përkatësisht për dy semestra të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet prej datës 1 Tetor ose 16 Shkurt deri me 30 Shtator të vitit përkatës akademik.”*

Në bazë të nenit 5 paragrafi 1 i kësaj rregulloreje, parashihet që *“procedura e angazhimit bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit.”*

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, ka vërtetuar faktin se e paditura me datën 14.09.2022, ka shpallur konkursin publik për pozitën një asistent për lëndët: “ Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, teknologji e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura, trajtimi i ujërave të zeza II dhe Materiet Ndotëse në Produkte të ushqimore” në të cilën pozitë, pas zhvillimit të procedurave ligjore në bazë të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, komisioni vlerësues ka propozuar kandidaten T.A.,

Tutje kundër kandidatja Y,B,, ka parashtruar ankesë të cilën Komisioni për Shqyrtimin e ankesave dhe Parashresave e kishte pranuar si të bazuar.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe parashresave ka gjetur se asnjë pikë e rregullores 1670 datës 28.09.2021 në lidhje me procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM nuk thotë se kandidatët duhet të testohen përkatësisht të futen në provim, pra këtu kanë vepruar në kundërshtim me rregulloren pasi kandidatët janë thirrur nga komisioni vlerësues t’i nënshtrohen provimit.

Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, me datën 25.10.2022 ka nxjerrë vendim me cilin ka anuluar konkursin e shpallur për pozitën “ një asistent për lëndët trajtimi i ujërave të zeza Monitorimi i Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore, Teknologjia e Ujit dhe Përpunimi i Ujërave të ndotura trajtimi i ujërave të zeza II, materiet ndotëse në produktet ushqimore për shkak të shkeljeve procedurale.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast nuk ka objekt të vendosjes për shkak se kërkesa e paditëses është që të anulohet vendimi I Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore i datës 25.10.2022, me të cilin është anuluar konkursi nr.2046 i shpallur me datën 14.09.2022, për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njëjësive akademike të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për vitin akademik 2022/2023.

Gjykata konstaton se Komisioni Vlerësues me rastin e shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve e në rastin konkret kandidates Y,B, nuk i ka prezantuar të gjitha faktet relevante në mënyrë tabelore të dhënat siç janë “(përmbledhja e aktivitetit shkencor për kandidatit) tek tabela II (mentorimi) nuk është shënuar asnjë e dhënë për kandidaten Ylebrinë Baliu, e po ashtu as në fushën e përvojës komisioni nuk ka shënuar asnjë të dhënë, në tabelën e tretë për publikimin e monografive, librave, kapitujve të librave dispensave, tabelën e IV për publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet në nivel ndërkombëtar dhe vendor, tabelën V për ligjërata-prezantime, ligjërues i ftuar në universitet dhe punëtori shkencor nga lëmi i kandidates si dhe tek tabela e VI. Për rektor/recesent në revistat akademike apo shkencore nuk është konstatuar asnjë e dhënë nga Komisioni Vlerësues, duke shkelur kështu nenin 6 pikën 12 të Rregullores për Procedurat Vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë i cili përcakton se “ Komisioni vlerësues ka për obligim që në raportin

vlerësues t'i prezantojë ë gjitha faktet relevante (në mënyrë tabelare) për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs për lëndën përkatëse.

Se Komisioni Vlerësues ka bërë shkelje procedurale gjatë shqyrtimit të dokumentacionit vërtetohet edhe nga deklaratimet e vet anëtarëve të komisionit në mbledhjen XLI të Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, mbajtur me datën 25.10.2022, në të cilën mbledhje “Prof. Sadija Kadriu kishte deklaruar se ishte inkuadruar me vonesë në komision dhe se njeriu i gjallë gabon, ka qenë kohë e shkurtër dhe jemi ballafaquar me probleme shëndetësore në familje dhe nuk kam mundur të kontribuojë me tërë qenien time, sa i përket provimit ne jemi nisur nga ajo sipas përzgjedhjes së kandidatëve të ngushtë të behët intervistimi por edhe ky ka qenë një gabim dhe e konsideroj të arsyeshëm raportin e komisionit të ankesave. Prof.Mehush Aliu, kishte edeklaruar se komisioni ka qenë kompakt edhe pse nuk janë plotësuar pikat e mobilitetet tek Y.. tutje kishte deklaruar se asnjëra nga kandidatet nuk i kishte dëgjuar të gjitha lëndët , ndërsa asistenti A.H.. kishte deklaruar se intervistimi është problemi kryesor, është problem procedural”.

Gjykata gjeti se Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, ka vepruar në përputhje me nenin 9.4 të Rregullores për Procedurat Vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “ Isa Boletini” në Mitrovicë i cili përcakton se “ *Komisioni i ankesave më së largu tre ditë pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës e dorëzon në Këshill të Fakultetit. Këshilli i Fakultetit në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtojë propozimin dhe të vendos për miratimin ose refuzimin e tij*” në vendimin numër 478/2 të datës 25.10.2022 me të cilin ka anuluar konkursin e shpallur me datën 14.09.2022 me numër nr.2046, për shkak se Komisioni Përzgjedhës kishte kryer shkelje procedurale të Rregullores nr.1670 të datës 28.09.2021 saktësisht nenit 6 pikës 10 dhe 12, duke mos prezantuar në mënyrë tabelore të gjitha faktet për secilin kandidat si dhe Komisioni kishte mbajtur testin me shkrim në vend të intervistimit ndonëse nuk ishte e përcaktuar me asnjë nen të Rregullores 1670/21 të datës 28.09.2021 as mënyra e testimit e as intervistimit.

Gjykata, ka refuzuar kërkesën e paditëses për anulimin e vendimit nr 478/2 të Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, pasi që gjeti se vendimi i datës 25.10.2022 nr. 478/2 është i drejtë dhe i ligjshëm i marrë sipas Rekomandimit të Komisionit për Shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësave pasi që i njëjti kishte konstatuar shkeljet procedurale të cekura si më lartë, ndërsa kërkesën për kompensimin në emër të pagave të papaguara e refuzoi si të pa bazuar sepse e njëjta gjatë periudhës për të cilën e kërkon kompensimin e pagave nuk ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën, përkatësisht me Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Në bazë të nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, nenit 10 paragrafi 1 dhe nenit 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës, rrjedh se marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktuale në mes të punëdhënësit dhe punëtorit e ku paga, të drejtat dhe detyrimet përcaktohen me kontratën e punës, dhe se kontrata e punës është akt formal i shkruar. Andaj, të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës krijohen dhe kanë efekt juridik vetëm nga momenti i lidhjes së kontratës në mes të palëve. Kësisoj, gjykata nuk mund ta obligoj punëdhënësin që t’ia kompensoj paditëses pagat për periudhën kur palët nuk kanë pasur të themeluar marrëdhënien e punës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452, 461 dhe 463 paragrafi 1 i LPK-së, duke marrë parasysh se paditësja e humbi kontestin ndërsa pala e paditur i kërkojë shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 779 euro €, përkatësisht nga 135€ për pesë seanca, 104 euro për përgjigje në padi, në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve dhe përpilimin e përgjigjes në padi. Me këtë rast, gjykata thekson se dispozita e nenit 461 të LPK-së, ka barazuar përfaqësuesin publik sa i përket të drejtës së shpërblimit të shpenzimeve të procedurës me avokatët dhe në këtë rast shpenzimet do të njihen sikur përfaqësuesi i të paditurit të ishte avokat.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti I Përgjithshëm – Divizioni Civil
2022:241704, 04.09.2024

Gj y q t a r j a

Erolinda Uka Sadiku

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Ndaj këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.